



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 10, datë 05.04.2022

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS E VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË Z. SANDËR BECI NË VENDIN VAKANT PËR ANËTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË NË DATËN 16.01.2017, 19.04.2019, 03.06.2021 DHE RISHPALLUR NË DATËN 31.01.2022 PËR SHKAK TË TËRHEQJES NGA KANDIDIMI DHE EMËRIMIT NË DETYRË SIPAS NJË PROCEDURE TË MËPARSHME

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare relatore
Elsa Toska	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Mema	Anëtare
Thoma Jano	Anëtar zëvendësues
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu,

Me praninë e Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (*në vijim KED*), të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: zotit Bledar Dervishaj, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës, dhe - zonjës Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit, në mbledhjen e datës 05.04.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Sandër Beci

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur në datën 31.01.2022.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji relatimin e zëvendëskryetares së KED-së, zonjës Marsida Xheferllari, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e KED-së, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Lartë, në datën 16.01.2017, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e plotë, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese pas mbarimit të mandatit të gjyqtares Vitore Tusha. Hapja e procedurës është shpallur në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000).
2. KED, duke mos u plotësuar numri i kandidatëve për këtë vend vakant, me vendimin nr. 6, datë 05.04.2019, ka vendosur: “Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur”, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.
3. Gjykata e Lartë ka rishpallur, më datë 19.04.2019, hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant, në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000.
4. Ndodhur në kushtet e mungesës së kandidaturave, më datën 03.06.2021, Gjykata e Lartë, me të njëjtën bazë ligjore, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant. Pas përfundimit të afatit, kjo Gjykatë i ka dërguar KED-së, një listë të dytë të kandidatëve, që i ishin përgjigjur rithirrjes së saj, të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore.
5. Në vijim, KED në mbledhjen e datës 12.07.2021 vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 6, datë 05.04.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”, si dhe rifillimin e procesit të shqyrtimit të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
6. KED, duke qenë se numri i kandidatëve ra nën tre, me vendimin nr. 31, datë 22.12.2021, ka vendosur pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

7. Në datën 31.01.2022, Gjykata e Lartë, me të njëjtën bazë ligjore, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant. Pas përfundimit të afatit, kjo Gjykatë i ka dërguar KED-së, listën e kandidatëve, që i ishin përgjigjur rithirrjes së saj, të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kritereve ligjore, në të cilën përfshihej kandidati Sandër Beci, i cili kishte aplikuar në datën 03.03.2022.

8. Në mbledhjen e datës 15.03.2022, KED realizoi procedurën e shortit manual për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 115/2016), pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja Marsida Xhaferllari, ndërsa këshilltare ligjore Laureta Nezaj.

9. Në datën 16.03.2022, kandidati Sandër Beci u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formave standarde dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, në adresën e postës elektronike të deklaruar nga vetë kandidati dhe kopje e tij është administruar në dosjen e kandidimit.

10. Në datën 15 mars 2022, kandidati z. Sandër Beci, u zgjedh nga Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 125 pika 1 e Kushtetutës, për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në një procedurë verifikimi të mëparshme dhe të përfunduar nga KED në vitin 2021. Në vijim, në datën 23.03.2022, Presidenti i Republikës zhvilloi ceremoninë për betimin e z. Sandër Beci, në cilësinë e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, dhe për rrjedhojë ai fillon detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

11. Me kërkesë të KED-së, të dërguar në rrugë elektronike për të konfirmuar mungesën e interesit për konkurimin e mëtejshëm në vakancat e tjera, z. Sandër Beci me e-mailin e datës 24.03.2022, është shprehur se: “Duke ju falenderuar për urimin dhe mirëkuptimin që kemi patur në të gjithë komunikimin tonë, Ju bëj me dije se për shkak të zgjedhjes sime në Gjykatën Kushtetuese, heq dorë nga kandidimi në dy vakancat e tjera të kësaj Gjykate për të cilat kam shprehur interesin”.

12. Tërheqja nga kandidimi është një e drejtë që i njihet kandidatit nga pika 8 e vendimit nr. 4/2019 të KED-së, e cila parashikon shprehimisht “8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”. Ndërsa pika 31 e të njëjtit vendim përcakton veprimet e relatorit që pasojnë njoftimin e tërheqjes nga kandidimi dhe konkretisht “31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA ELARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.

13. Sa më sipër, në datën 24.03.2022 u përgatit relacioni që përshkruante procedurën e zhvilluar, që shoqërohej edhe nga projekt-akti për përfundimin e procedurës së kandidimit të kandidatit Sandër Beci për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 31.01.2022. Këto akte iu paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje mbledhjes së KED-së.

14. Gjithashtu, pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe caktimit të mbledhjes, kandidati Sandër Beci u njoftua rregullisht në rrugë elektronike për zhvillimin e mbledhjes, duke i dërguar edhe kopje të relacionit të përgatitur. Njoftimi u krye në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së dhe kopje e tij u administrua në dosjen e kandidatit.

15. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet të çështjes, iu dërguan edhe Avokatit të Popullit. Kopje e këtij njoftimi u administrua në dosjen e kandidatit.

16. Zhvillimi i mbledhjes në datën 05.04.2022, ora 15.00, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidatin Sandër Beci iu njoftua edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së. Kopje e këtyre njoftimeve gjithashtu u administruan në dosjen e kandidatit.

17. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të çështjes nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Sandër Beci.

18. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se shkak për ndërprerjen e procedurës ashtu dhe shkak i rënies së interesit të kandidatit Sandër Beci është i qartë, përse kohë që tashmë është anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe për rrjedhojë, kjo procedurë verifikimi duhet të ndërpritet.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

19. KED, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga relatori i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur në datën 31.01.2022, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjes së kandidatit Sandër Beci.

20. Në pikën 1 të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë:

“1. shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Kryetari i Gjykatës së Lartë pranon kandidaturat brenda 30 ditëve nga njoftimi, i bën ato publike dhe ia dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi...”.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : **GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**

Adresa Elektronike : **info@ked.gov.al** Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

21. Në zbatim të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të Ligjit nr. 115/2016, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017, 03.06.2021 dhe rishpallur në datën 31.01.2022, KED ka filluar në datën 16.03.2022 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.

22. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e mosparaqitjes apo të tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të KED-së në raste të tilla. Nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se :

“2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.

23. Mbi bazën e këtij autorizimi ligjor, KED ka nxjerrë vendimin nr. 4/2019. Në pikat në pikat 8 dhe 31 të këtij vendimi parashikohet se:

“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.

“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.

24. KED, në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore, të zbatueshme në rastin e mosparaqitjes dhe tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit Sandër Beci. Kandidati është njoftuar rregullisht për fillimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 16.03.2022. Në datën 15 mars 2022, kandidati z. Sandër Beci, u zgjodh nga Mbledhja e Posaçme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, sipas nenit 125 pika 1 e Kushtetutës, për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në një procedurë verifikimi të mëparshme dhe të përfunduar nga KED në vitin 2021. Në vijim, në datën 23.03.2022, Presidenti i Republikës zhvilloi ceremoninë për betimin e z. Sandër Beci, në cilësinë e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, dhe për rrjedhojë ai fillon detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

25. Me kërkesë të KED-së, të dërguar në rrugë elektronike për të konfirmuar mungesën e interesit për konkurimin e mëtejshëm në vakancat e tjera, z. Sandër Beci me e-mailin e datës 24.03.2022, është shprehur se: *“Duke ju falenderuar për urimin dhe mirëkuptimin që kemi patur në të gjithë*

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri..

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonikë : +355 4 2257302

komunikimin tonë, Ju bëj me dije se për shkak të zgjedhjes sime në Gjykatën Kushtetuese, heq dorë nga kandidimi në dy vakancat e tjera të kësaj Gjykate për të cilat kam shprehur interesin”.

26. KED vlerëson të rregullt procedurën e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej kandidati Sandër Beci për tërheqjen nga kandidimi.

27. KED vlerëson që shprehja e interesit dhe kandidimi për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

28. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe pikave 8, 28, 31, 78 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës të kandidatis Sandër Beci, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 16.01.2017, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur në datën 31.01.2022, për shkak të tërheqjes së kandidatis nga kandidimi.

2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatis Sandër Beci.

3. Kandidati Sandër Beci ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAJ

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al Numra telefonike : +355 4 2257302